



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 509/4 Prot

Tiranë, më 21.09.2020

**V E N D I M**

Nr.94, datë 21.09.2020

***“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit nr. 99 (1634 prot.) datë 17.04.2020, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, për parregullsi të kryera në zhvillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm të nëpunësit \*\*\*\*\* dhe masat për përmirësimin e gjendjes”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenit 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga një kërkesë e paraqitur prej nëpunësit \*\*\*\*\*,

**Vërejtje se:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është paraqitur një kërkesë e regjistruar me nr.509 prot., datë 04.06.2020, nga nëpunësi \*\*\*\*\* , në të cilën janë parashtruar pretendimet e tij për parregullsi të kryera në zhvillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm (komandimit) të tij, e përmbyllur me aktin administrativ nr. 99 (nr. 1634 prot.) datë 17.04.2020 “Për komandimin e nëpunësit civil \*\*\*\*\*”, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar, konstatohet se punonjësi \*\*\*\*\* është nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Publike dhe Pastrimit”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, në Bashkinë Tropojë (emëruar me vendim nr. 115/9 (4547/12prot.) datë 14.12.2018), e për rrjedhojë, bazuar në nenin 2, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, shqyrtimi i kërkesës për vlerësimin e ligjshmërisë së një procedure administrative, përfshihet në juridiksionin e çështjeve që mbikëqyren prej Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civi.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyron veprimet administrative që janë kryer gjatë kësaj ecurie disiplinore, ka rezultuar sa më poshtë:

Komisioneri, për vlerësimin e ligjshmërisë së ketyre pretendimeve, nëpërmjet shkresës me nr. 509/1 prot., datë 12.06.2020, “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me kërkesën e regjistruar me nr. 509 prot., datë 04.06.2020, paraqitur nga nëpunësi \*\*\*\*\*”, ka vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të këtij rasti, duke i kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij.

Në përgjigje të këtij njoftimi, nga ana e institucionit të Bashkisë Tropojë, me shkresën nr.2367/1, datë 25.06.2020, “Kthim përgjigje”, protokolluar pranë Komisionerit me nr.509/2 prot., datë 03.07.2020, është dërguar sqarimi përkatës në lidhje me kërkesën e dërguar nga Komisioneri.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyron veprimet administrative që janë kryer gjatë këtij procesi, ka rezultuar e vërtetuar si më poshtë:

Me urdhrin nr. 99 (1634 prot.) datë 17.04.2020, Kryetari i Bashkisë Tropojë, ka vendosur transferimin e nëpunësit civil \*\*\*\*\* (pavarësisht përdorimit pa të drejtë, të termit “komandim”) për nevoja të institucionit, nga pozicioni “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Publike dhe Pastrimit”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike në Bashkinë Tropojë, në pozicionin “Specialist i shërbimeve publike” në Njësinë Administrative Lekbibaj, të kësaj bashkie.

Duke mos qenë dakord me vendimin e transferimit, nëpunësi në fjalë, i është drejtuar njësisë përgjegjëse të institucionit, me shkresën nr. 1920/1, datë 24.04.2020, nëpërmjet të cilës ka refuzuar transferimin e njëkohësisht ka kërkuar rishikimin e urdhërit të mësipërm, për shkak se në këtë rast nuk janë respektuar kërkesat e nenit 48, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Nga materialet që disponojmë, si dhe nga sqarimet në rrugë telefonike me institucionin, rezulton se aktualisht, nëpunësi \*\*\*\*\* vazhdon të jetë me raport mjekësor, duke justifikuar paaftësinë e tij për t'u paraqitur në punë.

Duke vazhduar më tej analizën, konstatohet se ky “komandim” bëhet për nevoja të institucionit, deri në një urdhër të dytë.

Nisur nga këqyrja e aktit rezulton se megjithëse pretendohet se ky transferim është bërë për nevoja të institucionit, ai nuk mund të konsiderohet si transferim i përkohshëm, pasi në këtë rast nuk janë respektuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe pikën 2, të Kreut I, të Vendimit nr.125 dt. 17.2.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, ku thuhet shprehimisht:

*“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, sipas rastit, përkatësisht brenda institucionit ku është emëruar, përfshirë edhe degët e tij territoriale, në një institucion të varësisë së institucionit ku është emëruar, në një institucion tjetër të shërbimit civil:*

*a) Në interes të institucionit, deri në 6 (gjashtë) muaj me/ose pa ndërprerje, gjatë 2 viteve;”;*

Këto dispozita parashikojnë se, në rastet kur paraqiten nevoja të tilla, do të plotësohen vetëm nëpërmjet transferimit të përkohshëm, deri në 6 muaj me/ose pa ndërprerje, gjatë dy viteve, brenda dhe në interes të institucionit, me kusht ruajtjen e kategorisë së nëpunësit.

Më tej, në pikën 5 të po këtij kreu, përcaktohet:

*“Transferimi i përkohshëm, në bazë të shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila, njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet”. Pra, nga sa më sipër, transferimi i një nëpunësi civil në një pozicion tjetër të shërbimit civil për nevoja të institucionit, miratohet nga njësia përgjegjëse dhe nuk mund të zgjasë më shumë se 6 muaj në dy vite.*

Nisur nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme dhe këqyrja e aktit nr. 99 (1634 prot.,) datë 17.04.2020, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, arrijmë në përfundimin se jemi para një akti të paligjshëm, qoftë për shkak të mosrespektimit të kushtit të përcaktuar në ligj për ruajtjen e kategorisë së pozicionit të punës ashtu dhe për shkak se në akt nuk është përcaktuar afati i transferimit, përcaktuar në pikën 2/a të Vendimit nr. 125 dt. 17.2.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, por është përdorur shprehja e paparashikuar nga ligji, se transferimi do të vazhdojë “deri në një urdhër të dytë...”.

Evidentimi i këtyre mangësive sjell pasojën që urdhri nr. 99 (1634 prot.) datë 17.04.2020, i Kryetarit të Bashkisë Tropojë, për komandimin e nëpunësit civil \*\*\*\*\* (bazuar në pikën dh), të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, duhet të anulohet pasi përbën ushtrim të diskrecionit në mënyrë jo të ligjshme.

Ky akt, në bazë të pikës 1, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, duhet të anulohet nga vetë organi publik që e ka nxjerrë, me një akt të ri me shkrim, sipas pikës 3 të dispozitës në fjalë.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; bazuar në nenet 108, 110, 111 e 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga ana e organit publik, Kryetari i Bashkisë Tropojë, që bazuar në nenin 113, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, me një akt të ri me shkrim, të anulojë aktin administrativ nr. 99 (1634 prot.) datë 17.04.2020, “Për komandimin e nëpunësit civil \*\*\*\*\*” si një akt i paligjshëm, duke kthyer gjithçka në gjendjen e mëparshme.
2. Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Tropojë, të krijojë të gjitha kushtet e të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për zbatimin e detyrës së mësipërme.
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 10 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke

përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

6. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Tropojë dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**